



Prishtinë, 22.04.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3153_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2913_02_26** i datës 20.02.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 01.04.2026.

në seancën e mbajtur më datë **22.04.2026** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **L. I.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2913_02_26 i datës 20.02.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 20.02.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2913_02_26 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit L. I., me shifër 00002627 dhe e ka obliguar NQ Termokos që për periudhën 12/2024 dhe 01-02/2025, konsumatorin ta liroj nga komponenta e tarifave për konsum të përbashkët, ashtu që për këtë periudhë të faturohet vetëm me sipërfaqe ngrohëse.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori L. I., brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- E kundërshtoj vendimin në pjesën ku lejohet faturimi pa matje C33, dhe nuk urdhërohet korrigjimi i plotë i faturave;
- Përgjegjësia për sistemin e matjes bie mbi operatorin dhe faturimi pa matje nuk mund të përdoret si rregull;
- Rasti nuk është analizuar individualisht dhe kërkon nga Bordi, që të anulohet vendimi për pjesën refuzuese të tij, dhe ta obligojë NQ Termokos që të korrigjimi i plotë i faturave.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 01.04.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 20.02.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 28.04.2025, Përgjigjen e NQ Termokos, Faturat e kontestuara, Kartelën e konsumatorit me shifër 002627; të dhënat nga leximi dhe faturimi për gjithë sezonën ngrohëse 2024/25; Informacionet e NQ Termokos të dt. 13.02.2026, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, vihet re që, konsumatori për sezonën ngrohëse 2024/25, për muajt 10-11/2024 është faturuar me sipërfaqe ngrohëse nga NQ Termokos, ndërkaq, duke filluar nga muaji 12/2024 si dhe 01-02/2025, duke qenë se konsumatori i ka pasur të instaluar matësit, por që, për shkak të problemeve teknike që janë shfaqur në sistem, konsumatori është faturuar me sipërfaqe ngrohëse, ose me tarifën C33. Pra, nuk është faturim me matje, por me sipërfaqe ngrohëse, përfshirë konsumin e përbashkët. Ndërkaq, për muajt 03-04/2025, konsumatori është faturuar me matje ose me tarifën C11, sipas gjendjeve të regjistruara në sistemin matës të konsumatorit.

Ndërlidhur me këtë rast, shkalla e parë në ZRrE –DMK, ka kërkuar sqarime nga NQ Termokos, dhe se sqarimet janë dhënë si në vijim: *“Sipas evidencave në sistem, konsumatori L. I., me shifër 0002627 ka pasur një pajisje të duplikuar me konsumatorin L.P., me shifër 020824. Para fillimit të sezonës, është tentuar kontaktimi telefonik i konsumatorit për rregullimin e problemit, mirëpo ai nuk është lajmëruar. Konsumatori është paraqitur me ankesë në fund të muajit 01/2025. Ky duplikim, ka qenë aktiv deri në muajin 02/2025, kur ekipet tona e kanë vizituar banesën e konsumatorit në terren për identifikimin e saktë të numrit serik të matësve. Si rezultat i identifikimit të saktë, faturat për muajt 03-04/2025 nuk janë ndikuar nga kjo ngatërrësë dhe janë lëshuar në bazë të tarifës C11 (me shpenzim)”. Bordi i ka analizuar me kujdes të dhënat e gjeneruara nga sistemi matës i konsumatorit, dhe ka gjetur se, qëndrojnë konstatimet e NQ Termokos lidhur me duplikimin e të dhënave me një konsumator me një shifër tjetër, andaj, me të drejtë nga NQ Termokos, është aplikuar faturimi me sipërfaqe ngrohëse ose pa matje me tarifën C33, në mungesë të të dhënave të sakta për shpenzimin e konsumatorit.*

Faturimi me sipërfaqe ngrohëse, për konsumatorët të cilët i kanë të vendosur matësit/alokatorët, do të zbatohet vetëm përkohësisht dhe në mungesë të leximit të saktë të shpenzimit të energjisë termike nga konsumatori, si bie fjala, kur sistemi matës mund të ketë ndonjë defekt teknik dhe kjo, vetëm përkohësisht, deri në sanimin e problemit. Sipas të dhënave të pranuar nga NQ Termokos, të gjithë konsumatorët të cilët kanë pasur të instaluar pajisje matëse HCA (alokator) apo edhe pajisje matëse, janë faturuar pa matje/me sipërfaqe ngrohëse, për shkak të defekteve që këto pajisje i kanë shfaqur në sistem. Rrjedhimisht, në mungesë të të dhënave të sakta për impulset e regjistruara, e që do të rezultonin në faturim të pasaktë, për këta konsumatorë, është aplikuar forma e faturimit pa matje, për shkak se praktikisht, nuk ekziston një mënyrë tjetër e faturimit.

Në këtë kuptim, duke qenë se, për konsumatorët të cilët posedojnë pajisje matëse funksionale në parim, e të cilave u paraqiten probleme teknike të paqëllimshme dhe të dokumentuara, nuk duhet t’u ngarkohet shpenzimi i përbashkët, për periudhën për të cilën këto gabime janë aktive dhe të konfirmuara. Andaj, duke qenë se, problemet teknike të shfaqura në sistemin matës të konsumatorit



nuk janë shkaktuar me ndërhyrjen e qëllimshme të konsumatorit, ose në ndonjë formë tjetër të kundërligjshme, Bordi e vlerëson që, konsumatori duhet të lirohet nga pjesa e konsumit të përbashkët, për **faturat e pranuar me C33 për muajt 12/2024 dhe 01-02/2025.**

Më tej, duke iu referuar edhe nenit 30 – Pajisjet matëse, të Ligjit për Energjinë Termike, është e përcaktuar si në vijim: *“1. **Furnizimi me energji termike matet me pajisje matëse** ndërsa, instalimi, operimi, mirëmbajtja apo zëvendësimi i pajisjeve për matje, bëhet në pajtim me Kodin e Matjes. 2. Energjia termike e shfrytëzuar nga konsumatori llogaritet me pajisje për matje që është pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 3. Tek konsumatorët fundor individual -objekte individuale të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në pikën e furnizimit, sa më afër kufirit të pronës së konsumatorit. 4. Tek konsumatorët fundor në ndërtesa kolektive - objekte kolektive të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në hapësirat e secilit konsumatorë, nëse është teknikisht e mundshme dhe leximi duhet të bëhet pa pasur qasje në hapësirat e banimit të konsumatorit. 5. Kufiri i pronës, përgjegjësia për objektet termike, vendi për vendosjen e pajisjeve matëse dhe të gjitha aspektet tjera të matjes përcaktohen me Kodin e Matjes”.* Pra, faturimi me matje është kërkesë ligjore, e për më tepër, edhe projekti i vendosjes së matësve e ka këtë qëllim, që konsumatorët të kursejnë dhe të shfrytëzojnë energjinë termike në mënyrë racionale dhe rrjedhimisht, të paguajnë aq sa shpenzojnë.

Duke u bazuar në nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si në vijim: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*, Bordi thekson se, NQ Termokos, ka vepruar në harmoni me kërkesat ligjore që burojnë nga legjislacioni sekondar.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 6 – Furnizimi me Energji termike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë termike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë termike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuar nga NQ Termokos, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit L. I.,
- Arkivit të ZRrE-së